VENDIM
Nr. 218, datë 1.9.2022

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "BINDI" SHPK PËR RINOVIMIN E LICENCËS, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 170, DATË 26.10.2017

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", si dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1504/1 prot., datë 29.8.2022, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Bindi' sh.p.k. për rinovimin e licencës, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017",

konstatoi se:

- Shoqëria "Bindi" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 387, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1385/3 prot., datë 18.8.2022, ajo ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence.

- Në zbatim të nenit 16, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, i licencuari duhet të paraqesë në ERE një aplikim për rinovim licence jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Aplikimi i shoqërisë "Bindi" sh.p.k. për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike është paraqitur në afat.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin lidhur me nenin 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c"; nenin 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d" dhe "e"; nenin 9, pika 3, germat "a", "b" dhe "d", si dhe nenin 9, pika 4.8, germat "a", "b" dhe "c".

Në këtë aplikim mungon dokumenti, si më poshtë vijon:

Neni 9, pika 3:

- Germa "c": Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dhe deklaratën e ortakut të vetëm të saj, ku të jepet miratimi i tij për të mbështetur veprimtarinë e shoqërisë "Bindi" sh.p.k. nëpërmjet të ardhurave të tij personale, sipas kapitalit të deklaruar nga vetë shoqëria.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "Bindi" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti